Parametri	Perpara trajnimit				Nga vendi i lirim/leshimit pas shkarkimit			
	Mesatarja max.0 vleres/ore (mg/l)	Mesatarja e max. o vleres ditore (mg/l)	Kg/vit	Kg/vit	Vlera mesatare maks. Ne ore (mg/l)	Vlera ditore mesatare maks. Ne ore (mg/l)	Kg/vit	Kg/vit

Shenim: Nuk eshte monitoruar si aktivitet

Shotja III: Kapja dhe trajtimi i ndotjes dhe shkarkimeve ne mjedis dhe mbetjeve**1. Trajtimi i ndotjes**

Lloji i shkarkimit/ndotjes (ne ajer, toke, uje)	Pershkrimi i trajnimit
Ne uje	Do te perdoret sistem septik standard me tre ndarje dhe sistem grille me mjediset e pune pasi ujerat jane vetem te ngarkuar me mbejte te ngurta si mbejte organike, leter, qelq, etj
Ne Toke	Nuk ka ndotje
Ne ajer	Nuk vlersohet e nevojshme pasi jave vetem avuj uji pasi perdoret gaz i lengshem dhe energji elektrike

2. Menaxhimi i mbetjeve

Materiale mbetjesh	Numri nga Rregullorja per Kategorite e Mbetjeve, duke perfshire listat	Vendi kryesor i gjenerimit	Sasia		Trajtimi ose asgjesimi ne instalim/impiant (Metoda dhe vendodhja)	Trajtimi, rikuperimi riciklimki ose asgjesimi jashte instalimit/impianti (Metoda, vendi, kontraktori)
			Ton/muaj	m ³ /muaj		
Vajra te perdorur	12 01 10*	Njesia e sherbimit te automjeteve	0.5		Kontraktor te licensuar	Riciklim (Proces kimik trajimi sekondar)
Qelq	19 12 05	Zyrat dhe sherbimi	0.05		Kontraktore	Riciklim Tirane
Lende organike	16 03 06	Mjedisi i perpunimit	0.1		Vend grumbulli urban	Komuna Kashar
Metale dhe metalore	19 12 02Metale ferore 19 12 03Metale joferore	Zyrat dhe sherbimi	0.02		Kontraktore	Riciklim Tirane
Plastik dhe gomë	19 12 04	Zyrat dhe sherbimi	0.01		Kontraktore	Riciklim Tirane

Programi i vetmonitorimit te shkarkimeve ne vijueshmeri per Vitin 2013

Vendodhja e monitorimit/Koordinatat ne Sistemin e Koordinimit UTM: N/a

Parametri ⁻¹	Rezultatet (mg/l ose mg/m ³)	Metoda e marrjes se mostres	Qellimi/arsyeja e vleresimit analitik	Metoda analitike / teknika

	Data	Data	Data	Data	Me instalim te levizhem	Vleresim i impaktit	lartesia 8.4 ml
CO							
NO2							
SO2							
O2							

6. ASPEKTE MJEDISORE DIREKTE DHE INDIREKTE

FIT- MEK- OIL per nje implementim dhe menaxhim efikas te sistemit, ka marre ne konsiderate si aspektet direkte ashtu edhe ato indirekte; nje individualizim i tille kryhet cdo vit nepermjet nje mbledhje te te dhenave dhe informacioneve dhe te nje vleresimi te meparshem te rendesise se tyre duke aplikuar disa kritere te reja te pershkruara ne proceduren e identifikimit dhe vleresimit te aspekteve mjedisore. Nepermjet Analizes Fillestare Mjedisore mund te programohen dhe kontrollohen jo vetem kostot e menaxhimit mjedisor por edhe impaktet e shkaktuara nga kompania ne mjedis gjate aktiviteteve.

Ne kete menyre individualizohen aspektet mjedisore te rendesishem qe duhen mbajtur nen kontroll (si ne situata normale ashtu edhe ne situata emergjente) nepermjet indikatorëve te mundshem, qe mund te merren si referim per pergatitjen e nje bilanci mjedisor qe evidenton zoant/aktivitetet ne te cilat mund te reduktohen kostot dhe shpenzimet.

Aspektet mjedisore te marra si referim ne pergatitjen e Analizes Mjedisore Fillestare mund te permbidhen dhe te ndahen si vijon.

Aspekte direkte

Me *aspekte direkte* nenkuptohen ata te cilet vijne nga aktivite te cilet hyjne nen kontrollin menaxhues te kompanise. Per cdo aspekt merren impantet interesante, dispozitat ligjore, aspekti mjedisor dhe natyra e impaktit.

- ↳ Konsumi i burimeve natyrore (lende te para)
- ↳ Burime energjitike dhe sasia e perdorur
- ↳ Shkarkimet hidrike (ujrat industriale, ujrat nga rreshjet) Emetime ne atmosfere
- ↳ Shkarkime ne toke
- ↳ Prodhimi i mbetjeve
- ↳ Zhurma e “prodhuar” jashte

Aspekte indirekte

Me *aspkte indirekte* nenkuptohen ata aspekte qe vijne nga aktivite te kryera kryesisht nga furnitoret dhe kontraktuesit; aktivite te tilla nuk kontrollohen dhe menaxhohen plotesisht nga kompania, por ne nje menyre influencohen nepermjet procedurave per te siguruar qe ne kryerjen e aktivitetëve nga personeli i te treteve te respektohen kerkesat e mbrojtjes se mjedisit koherente me politiken mjedisore te kompanise.

- ↳ Emetimet e gazeve te shkarkimit te automjeteve te furnitoreve dhe nen kontraktoreve
- ↳ Mbetjet e prodhuara nga furnitoret dhe nenkontraktoret
- ↳ Sjelljet mjedisore te furnitoreve dhe nenkontraktoreve





Nje dokument i tille eshte strukturuar ne menyre qe te azhurnohet sa here qe ka te reja te rendesishme per produktet ose proceset.

Per kete qellim azhurnohet “Regjistri i Impakteve Mjedisore”, edhe me qellimin per te monitoruar efikasitetin dhe eficensen e objektivave dhe programeve mjedisore.

Nga analiza mjedisore fillestare dhe nga azhurnimet qe do te kete lind kuadri i meposhtem i rendesise se aspekteve mjedisore te perpunuara (duke perseritur te njejten simbiologji):

Kodi	Rishqyrtimi	Data	Emetimi	Aprovimi	Faqja
III_1_A	Rev-0	03.06..2013	S_1	Inv	Faqja 20 nga 30

REGJISTRI I IMPAKTEVE MJEDISORE										
	ASPEKT MJEDISOR	Toke Shtete			Aprovim			Vijeshmeri		
		09	10	11	12	13	14	15	23	29
1	KONSUMI I BURIMEVE									
2	EMETIMET NE ATMOSFERE									
3	SUBSTANCA TE DEMSHME									
4	TRANSPORTI									
5	SHKARKIMET HIDRIKE DHE NE TOKE									
6	MBETJET									
7	EMETIMET AKUSTIKE									

KLASA E IMPAKTIT	PERKUFIZIMI	PER OBJEKTIVA	PER PROCEDURA
 = 1	Aspektet qe i perkasin klases "1" mund te konsiderohen jo te rëndesishem dhe nuk parashikojne nderhyrje te vecanta permiresuese.		
 = 2	Aspektet qe i perkasin klases "2" mund te konsiderohen si parendesishem por duhet te jene objekt i aktiviteteve te kontrollit dhe mbikqyrjes te kryera per te garantuar sistemin mjedisor.		
 = 3,4	Aspektet qe i perkasin klases "3, 4" duhet te merren ne konsiderate ne percaktimin e objektivave dhe programeve per permiresimin mjedisor te pershtatur me veshitresine dhe urgjencen e situates se ndodhur. Nese eshte e nevojshme duhet te parashikohen procedura kontrolli.		
	Me nje simbol te tille tregohet nje afat i detyrueshem.		

7. VLERESIMI I SENSIBILITETIT SOCIO-TERRITORIAL

Ne kapitujt e mëparshëm janë përcaktuar parametrat e Rendesise dhe Eficenses që karakterizojnë aspektet mjedisore që lidhen me aktivitetet e kryera.

Ne këtë paragraf, duke ju referuar asaj që është përshkruar më lart në strukturën mjedisore, përcaktohet një parameter tjetër gjysem-sasior, "sensibiliteti socio –territorial", që së bashku me dy parametrat e tjerë do të çojë në individualizimin e një parametri të fundit, "prioriteti", i përcaktuar si niveli i rendesise së një aspekti mjedisor specifik mbi të cilin mund të vepohet për implementimin e masave të përmirësimit.

Ne vleresimet e kryera me parë përcaktohej, vecanerisht, "niveli" i "rendesise" për aspektet të ndryshëm mjedisore të analizuar; një nivel i tillë merrte parasysh vetëm rrezikun e brendshëm dhe potencial që aspekti kishte në mjedis.

Sensibilizimi socio-territorial jep një informacion mbi ekzistencën e receptoreve shumë të ndjeshëm, jashtë stabilitetit, që në një mënyrë ose tjetër mund të influencojnë studimin e disa argumenteve në strukturimin e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor kur parashikohet një "dem i madh" ose një "risk me i madh".

Analiza dhe Vleresimi i sensibilitetit në rastin në fjalë, i referohet receptoreve shumë të ndjeshëm të individualizuar në një zonë me influencë rreth 5 Km.

Përcaktimi i niveleve të sensibilitetit socio-territoriale është kryer nepermjet plotësimit të skedave të vlerësimit që janë në Tabelën 10.1 në të cilën analizohen receptoret e ndjeshëm të individualizuar me prioritet me aspekte mjedisore të ndryshëm të trajtuar në kapitujt e mëparshëm sipas 4 niveleve (SST) duke ndjekur kriteret e:

- ↻ Rendesise së aspektit mjedisor;
- ↻ Rendesise së receptoreve të ndjeshëm dhe distancës së tyre nga zona;
- ↻ Ekzistencës ose mungesës së mbrojtjes natyrore ndërmjet impaktit mjedisor dhe receptorit të ndjeshëm.

Nivelet e sensibilizimit të ndarë për çdo aspekt mjedisor (Sam), përcaktojnë nivelet e sensibilizimit socio-territorial (Sst) që vijne nga mesatarja e niveleve të vecanta të ndarë gjithnjë në 4 nivelet që i korespondojnë:

- ↻ Sst = 1 – Sensibilizimi - asgjë
- ↻ Sst = 2 - Sensibilizimi – i ulët
- ↻ Sst = 3 - Sensibilizimi - mesatar
- ↻ Sst = 4 - Sensibilizimi – i lartë

Në rastin e studimit, rezultatet e arritura skematizohen në tabelën e mëposhtme, së bashku me një përshkrim të shkurtër të elementeve që i karakterizojnë dhe të receptorit të ndjeshëm që kanë përcaktuar rezultatin e vlerësimit.

Tabela 10.1 : Aspekte mjedisore dhe niveli i sensibilizimit

Kodi	Rishqyrtimi	Data	Emetimi	Aprovimi	Faqja
III_1_A	Rev-0	03.06..2013	S_1	Inv	Faqja 22 nga 30

ASPEKTI MJEDISOR	niveli Sst
BURIME HIDRIKE	1
BURIMET ENERGJITIKE	1
EMETIMET NE ATMOSFERE	1
MBETJET	2
SHKARKIMET HIDRIKE DHE NE TOKE	1
ZHURMA	1

Rezultatet e vleresimit, evidentojne nje sensibilizim socio-territorial per tipe te ndryshme te aspekteve mjedisore te marra ne konsiderate ne lidhje me perdorimin e territorit qe nuk prezanton asnje pengese panoramike.

Nenvizohet se vleresimi eshte kryer vetem per te vepruar ne mekanizmin e perzgjedhjes se prioritetit dhe keshtu duhet te perdoret vetem per kete qellim, sepse gjykimet dhe perfundimet e marra nga ai ndoshta nuk e ruajne rendesine e tyre nese largohen nga ky kontekst.

8. VLERESIMI I PRIORITETIT TE VEPRIMEVE TE PERMIRESIMIT

Percaktimi dhe llogaritja e prioriteteve te nderhyrjes per permiresimin e performancave mjedisore te zones

“Prioriteti” eshte nje parameter qe tregon, nepermjet nje indeksi numerik, hierarkine racionale te veprimeve qe kompania duhet te ndermarre per vazhdimesine e permiresimit te vazhdueshem te performances mjedisore te aktiviteve te kryera ne stabilimentin e saj.

Duke ju referuar metodologjise se vleresimit te prioriteteve te nderhyrjes te cituara ne kete udhezues, dhe perpunimit te niveleve te caktuara per cdo aspekt (Rendesia, Eficensa dhe Sensibilizimi Socio-Territorial), individualizohen shkalle te ndryshme te prioriteteve te nderhyrjes.

Algoritmi i llogaritjes se prioriteteve parashikon produktin e niveleve te ndryshem te permbledhur ne tre parametra qe percaktojne keto prioritete, si Rendesia (VR), Eficensa menaxhuese (EM) dhe Sensibilizimi Socio-Territorial (SST).

Rezultatet e nje produkti te tille percaktojne nivelet qe identifikojne parametrin “prioritet”.

Cdo aspekt mjedisor i perpunuar ka nje nivel prioriteti ne baze te perpunimit te nivelit te perpunimit te prioritetit te nderhyrjes (Prioriteti Mjedisor).

Ne fazen e mbledhjes se informacioneve u pa se duhej krijuar nje kuader me i qarte i impakteve mjedisore qe lidhen me aktivitetet e kompanise. Ne kete faze preferohet te shtohet serisht e dhena e marre me pare dhe te kryhet nje analize per cdo impakt.

Ne tabelen n° 11.1 jane mbledhur, per cdo aspekt mjedisor, nivelet e “prioritetit” te individualizuar ne kushte funksionimi normale, anormale dhe ne situatat e emergjences te aktiviteve te pranishem ne stabilimentin e FIT- MEK-OIL SHPK

11.2 Sinteza e prioriteteve te aspekteve mjedisore

Aspekte Mjedisore	Niveli			
	Rv	E _{GEST.}	S _{ST}	Prioriteti Mjedisor
1) burime hidrike	2.4	1.2	1	4.6
2) burime enrgjitike	2,34	1.2	1	4.54
3) emetime ne atmosfere	1,5	1.4	1	3.9
4)shkarkimet hidrike dhe ne toke	2	1.4	1	4.4
5) mbetje	1.25	1.2	2	4.45
6) shkaktimi i zhurmave	1,5	1.8	1	4.3

Per vleresimin e prioriteteve te nderhyrjeve qe duhet te zbatohen, mund te percaktohet nje kriter sipas se cilit mbahet nen kontroll te mjaftueshem aspekti ne fjale dhe si pasoje klasifikohet si jo kritik.

Nga rezultatet e vleresimit te prioritetit, rezulton se aspektet me kritike i perkasin shkarkimet hidrike dhe ne toke, sepse ky rezultat eshte me i madh se 10 % se vleres maksimale (4 x 4 x4= 64). Rezultojne jo kritike aspektet e tjere.

Kodi	Rishqyrtimi	Data	Emetimi	Aprovimi	Faqja
III_1_A	Rev-0	03.06..2013	S_1	Inv	Faqja 24 nga 30

9. MASAT KRYESORE LEHTESUESE.

Masat lehtesuese qe do te ndermerren gjate shfrytezimit te objektit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të aksidenteve dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe do te zbatohen dhe zbatohen nga subjekti **FIT-MEK-OIL SHPK** Ndikimet negative ne mjedis gjate shfrytezimit te zones jane ne nivele shume te ulta. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte shenuar.

Gjatë zbatimit të projektit skema teknike e pikës së karburantit ka siguruar:

- Shkarkimi brenda normave të avujve në ajër, rrjedhjeve ujore.
- Shmangie deri në minimizim të rrjedhjeve në ajër, ujë dhe tokë të shkarkimeve ndotëse për mjedisin.
- Tokëzimi i rrjetit dhe impianteve energjike.
- Instalime të MKZ-it.
- Menaxhimi me efikasitet i territorit.
- Në çdo periudhë do të realizohen matje dhe analiza.

Mbajtjen në gjendje shumë të mirë teknike (të pajisjeve, sistemit të ngarkim- shkarkimit, sistemit të kontrollit, i rezervuarëve, etj).

Ky objekt nuk prodhon dhe nuk do të prodhojë ndotës për mjedisin nëse merren masa për të rehabilituar dhe monitoruar vazhdimisht mjedisin e punës dhe depot e karburantit. Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen nga shërbimi në objektin ekzistues do të depozitohen në vendet e përcaktuar nga Komuna Kashar

Nuk do të ketë ndotje akustike, rrezatimuse apo vibrime, etj që mund të jenë të rrezikshme për jetën e individëve dhe për mjedisin natyror. Për nevojat higjieno- sanitare, uji do të merret nga rrjeti i zones.

Do të merren masa si hapja dhe pastrimi i kolektorit përkatës si dhe të dekantuesit rezerve (për piken e karburantit) për dekantim të ujërave që grumbullohet me nivel të përmbajtjes së vajrave më të lartë se 10 mg/l. Gjatë pastrimit do të ndalet derdhja e tyre në mjediset ujore por do të grumbullohen në dhomat (ndarjet) e gropave septike rezervë në raste avarish. Depozita rezerve do te jete në përputhje me kushtet teknike në varësi të prurjeve në ditë të pikës së karburantit. Ujërat e trajtuar (ne rastet kur konstatohen ndotje te tyre) do të jenë brenda parametrave ndërsa ujërat e prodhuar nga shfrytezimi i projektit do të derdhen në sistemin e kanalizimeve ku ne fillim do te derdhen ne grope septike deri sa te ndertohet kolektori perkates.

Për të ulur nivelin e ndotjes nga pluhurat do të bëhet rregullisht lagia dhe larja e mjedisit përpara pikës së karburantit, shpëlarja e mjeteve transportues te ndotura me dhera para hyrjes së tyre në pikën e karburantit.

Izolohen në mënyrë hermetike për të shmangur daljen në mjedis të avujve nga tubi i ajërimit. Sistemi i ajërimit do të jetë i mbyllur si dhe më pas nuk do të "depozitohen" në troposferë por do të vendoset impianti i trajtimit (tubi i shkarkimit, filtra) të këtyre emisioneve. Këto emisione bëhen shkak të ndotjes termike për këtë arsye do të vendoset një avullues për uljen e temperaturave të ajrit para se të

Kodi	Rishqyrtimi	Data	Emetimi	Aprovimi	Faqja
III_1_A	Rev-0	03.06..2013	S_1	Inv	Faqja 25 nga 30

"shkarkohen në atmosferë, do të jenë në përputhje me kushtet klimaterike të mjedisit përreth.

- a) Depot nentokesore ku vendoset rezervuari duhet të ketë hyrje drejt për drejt nga jashtë;
- b) Muret që ndajnë kthinën e kaldajës nga ajo e rezervuarit duhet të jenë prej betoni te armuar te llogaritur nga inxh. Konstruktori.
- c) Hapesira midis rezervuareve nuk duhet të kenë lidhje te drejteperdrejte midis tyre por kjo hapesite do te mbushet me rere .
- d) Cdo rezervuar do të ketë tubin e ajrimit, i cili fillon nga pjesa më e lartë e rezervuarit dhe shkon me pjerrësi minimale 5% duke u ngjitur deri në 3 m mbi sipërfaqen e tokës. Mbarimi i tubacionit në atmosferë do të jetë me kthesë 180 gradë dhe i pajisur me valvol ajrimi të mbrojtjes nga zjarri.
- dh) Diametri i tubit të ajrimit do të jetë minimumi 25 mm për rezervuarët deri në 5 m dhe 38 mm. për rezervuarët mbi 5m.
- e) Vendi nga mbushet rezervuari do të jete i vendosur jashtë tendes se karburantit në mënyrë të tillë që automjeti i furnizimit të afrohet lëhtësisht.
- f) Tubi i mbushjes duhet të mbyllet me tapë me filetë ose kapak prej materiali me ngjyrë me filetë. Në vendin e mbushjes duhet të bëjmë një pus 50x50cm me kapak metalik mbyllur me dryn.
- g) Rezervuarët mbështeten në struktura të ndërtuara, me material të pa djegshem dhe do te jenë të pajisura me tubin e pastrimit dhe me tubin e shkarkimit si dhe treguesin e nivelit.
- gj) Në depozitimin e hidrokarbureve jane pajisur me një rezervuar me çati fikse e cila te pajiset me pjesë për mbledhje, riqarkullim dhe heqjen e avujve nga lëngje të tillë me efikasitet të paktën 99%. Ky efikasitet duhet të mos arrihet duke përdorur djegien, me përjashtim të rasteve kur rikondensimi i avujve është i rrezikshëm dhe i pamundshëm të realizohet teknikisht. Djegia mund të përdoret gjithashtu si fazë e dytë e pastrimit.
- h) Rezervuarët përputhen me izolim të përshtatshëm dhe veshje antirefleksive me të paktën 70% rrezatim të nxehtësisë radiante me qëllim zvogëlimin e ndryshimeve të vëllimit në lëngun e rezervuarit si pasojë e ndryshimeve të temperaturës së mjedisit të jashtëm; Kjo masë është efektive në një shkallë të kënaqshme.
- i) Për pompimin e substancave gjate shkarkimit nga tanket e lëvizshëm, ose gjatë ngarkimit të tyre nga tanket e magazinimit, duhen krijuar kushtet për grumbullimin, riqarkullimin dhe eliminimin e substancave të tilla me efikasitet jo më të vogël se 99% si dhe:
 1. Përdoren pompa që ndalojnë shpëtimin e substancave të pompuara për shembull me bllokim mekanik,
 2. Duhet që të paktën një linjë operimi për ngarkimin e tankeve të lëvizshëm duhet të pajiset për të ngarkuar tanket e lëvizshëm të ngarkimit nga fundi,

Në raste të aksidenteve dhe të avarive mund të themi se dëmi në mjedis do të ishte i madh, ku mund të përmendim rastet e aksidenteve të autoboteve gjatë transportimeve të tyre. Ndotja prej tyre do të ishte e pashmangshme. Disa masa parandaluese do të jenë si:

- Pranimi në punë i punëtorëve të kualifikuar ose trajnimi i tyre.
- Lëvizja e autoboteve në përputhje me kodin rrugor dhe me sinjalistikën e nevojshme të vendosura në autobus si dhe në mjediset e pikës së karburantit për të shmangur aksidente të shkaktuara nga pakujdesia e popullsisë vendase.
- Marrja në punë për transport të produkteve të personave të kualifikuar dhe me lejen e drejtimit përkatëse dhe me eksperiencë pune.
- Përdorimi i mjeteve mbrojtëse ndaj këtyre substancave.
- Monitorimi i vazhdueshëm i autoboteve dhe i pikës së karburantit nga persona të licencuar për të shmangur avaritë.
- Merren masa mbrojtëse kundra zjarrit në rast të ndezjes së tyre, shmangia e shkarkimit të tyre në atmosferë në rast avarish, dhe montimi i sistemit MKZ-së pranë depove të karburantit. Mbjajta me vete të dy bombolave me shkumë me rreth 70 l, portabël gjatë ngarkim-shkarkimit të autoboteve dhe të cisternave me karburant. Vendosja ne shesh si dhe ruajtja e rezervës së pa prekshme të ujit për shuarjen e

Kodi	Rishqyrtimi	Data	Emetimi	Aprovimi	Faqja
III_1_A	Rev-0	03.06..2013	S_1	Inv	Faqja 26 nga 30

zjarreve do të bëhet pasi marja e ujit drejt për së drejti nga burimi është e pamundur teknikisht si dhe me i leverdishem ekonomikisht. Vëllimi rezervës së pa prekshme të ujit do te merret barazi me harxhimin e ujit maksimal gjatë 3 orëve për shuarjen e zjarrit. Rezerva e paprekshme e ujit në sasi më shumë se 1.000 liter duhet te ruhet në dy rezervuarë. Për të shmangur harxhimin e ujit të rezervës së pa prekshme, për nevoja të tjera do të marrim masa të posacme. Madhësia e rezervuarëve, që përmbajnë rezervën e paprekshme, do te llogaritet duke parashikuar mbushjen e tyre gjatë shuarjes së zjarrit (3 orë) në mënyrë që uji të sigurohet pa ndërprerje për shuarjen e zjarrit.

□ Në rast urgjencash kontaktimi me zjarrfikësit e zonës përkatëse (vendosja e numrit të Zjarrfikëses 128 në një vend të lexueshëm nga të gjithë punëtorët).

Percaktimi i vijes hyrese dhe dalese per automjetet rrugore qe do te furnizohen me karburant si shmangia e aksidenteve gjate daljes nga ky shesh. Pajisja e kesaj rrugice me sinjalistiken perkatese.

Behet nje menaxhim sa me eficient i energjise elektrike. Impiantet e nevojshme per nje konfort termike ne objekt jane projektuar ne perputhje me Ligjin e ri, nr.9379, date 28-04-2005 'Per Eficencen Energjise', kjo do te coje ne uljen e ndotjeve termike te mikroklimes se zones si dhe kursim te energjise elektrike deri ne 50% nga perdorimi i materiale termoizolues.

Percaktimi i vend-parkimit te automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistiken perkatese per objektin qe eshte ne sherbim te ketij aktiviteti.

Instalohet sistem i ujitjes per mjedisin perreth (varet dhe nga hapesira e planifikuar per gjelberim si dhe pozicioni qe ato do te kene) si dhe lagia me uje e rrugicave te brendshme gjate periudhes Maj-Tetor.

Behet menaxhimi i mbetjeve te ngurta, te cilat do te jene; lende te aballazheve, letra-kartona, qelqe, alumine si dhe lende organike te prodhuara nga punonjesit apo nga sherbimi qe do te realizohet ne kete objekt, ku keto mbetje do te depozitohen ne vendin e caktuar nga Bashkia ku firma do te marre masa per menaxhimin e ketyre mbetjeve te ngurta, do te vendosen ne kosha selektive (nese do te filloje zbatimi i projektit te menaxhimit te mbetjeve) ku me pas do te transportohen nga automjetet e pastrimit te qytetit per ne vendet e caktuara prej tyre. Mbetjet e ngurta urbane te prodhuara, do te depozitohen ne kosha te percaktuar nga Bashkia , ku do te jete nje sasi prej 0.8kg/dite per banor ndersa per njesite eshte e variushme, eshte e lidhur ngushte dhe nga aktivitetet qe do te ushtrojne veprimtari ne godina. Per cdo objekt do te ndertohet xhepi i kontenjerit sipas kushteve te caktura nga sektori i pastrimit ne Komuna Kashar

Ndertohet kanali i drenazhimit te ujit te shiut nga catia ose e mjedisit perreth drejt mjedisve te gjeberuara, nje mundesi e mire dhe per vaditje dhe shmangie te derdhjes se tyre ne mjedis si dhe shmangie te perdorimit te ujit te pijshem per vaditje.

Mjedis i gjelberuar perreth do te jete nen kujdesjen e personelit qe do te punesohet vetem per punimet agro-mjedisore te nevojshme.

Tokezohet rrjeti elektrike per te shmangur ndonje shkarkese elektrike, konform kushteve teknike.

Merren keto masa kryesore te mbrojtjes kundra zjarrit per Objektin. Perdoret uji i marre nga rrjeti i shperndarjes se ujit apo nga rezervuarët qe do te vendosen ne sheshin perreth per rastet e emergjences (zjarret e mundshme qe mund te bien ne keto objekte). Numri maksimal i lejuar i kateve te objektit, shkalla e qendrueshmerise ndaj zjarrit e kerkuar per ndertesën dhe siperfaqja maksimale e lejuar e dyshemese ndermjet mureve mbrojtese kunder zjarrit, percaktohet sipas kategorise se rrezikut per zjarr te punimeve qe do te kryhen ne ndertese. Shkalla e qendrueshmerise ndaj zjarrit si dhe numri maksimal i lejuar i kateve ne teresi (ose te pjeseve te saj qe gjenden midis mureve mbrojtës kunder

Kodi	Rishqyrtimi	Data	Emetimi	Aprovimi	Faqja
III_1_A	Rev-0	03.06..2013	S_1	Inv	Faqja 27 nga 30

zjarrit) percaktohen sipas punimit me te rrezikshem per zjarr qe kryhet ne ndertese (ose te pjeseve te saj qe gjenden midis mureve mbrojtës kunder zjarrit). Rrjeti per shuarjen e zjarreve duhet te jete i lidhur me rrjetin e ujit perkates apo me rezervuar qe furnizohen nga pusi i hapur per nevojat e ketij objekti. Ndertimi i ujesjellesit te pavarur per fikjen e zjarrit lejohet vetem ne rastet kur nuk eshte e leverdiseshme qe aty te lidhet me ujesjellesin e ujit. Ne kete projekte harxhimi i ujit per shuarjen nga jashte te zjarreve duhet te merret 20 l/sek. Ujesjellesi per shuarjen nga zjarri duhet te ndertohet me presion te larte dhe te ulet. Hidratantet e brendeshme vendosen ne cdo kollone te ndertesës, pervec mbi tavane, sepse ne tavane do te instalohet sistemi i sprinkler. Ne mjedise te tjera, hidrantet e brendeshme duhet te vendosen kryesisht prane hyrjeve brenda kthinave, ose ne pushimet e kafazeve te shkalleve, ne korridoret ose ne kalimet, pikerisht ne vendet me te dukshme. Hidratet zjarrefikese te brendeshme vendosen 1.25 m nga niveli i dyshemese ku kapaciteti i tyre mbajtes do te jete 70L per cdo hidrant te montuar ne keto mjedise. Per te mbrojtur kunder zjarrit te mundshem qe mund te bjer ne objekt do te ruhen largesite mbrojtëse ndaj zjarrit ndermjet sheshit dhe objektit perreth si dhe ndermjete objektit qe ndodhet ne sheshin ne studim. Do te lihen distancat e percaktuara per rruge kalim te automjeteve, zjarrefiksive.

Per te shmangur ndotjen e ujerave nentokesore nga Ujerat te Ndotura Urbane te kesaj zone do te lidhet me rrjetin e kanalizimeve te kesaj zone, rrjeti do te projektohet konform kushteve teknike si dhe ne zbatim te legjislacionit ne fuqi. Ndersa ne lidhje ne burimet e furnizimit me uje, do te jene te mjaftueshme per te permbushur kerkesat gjate nje viti, veçanerisht gjate muajve te verës, kur normalisht kerkesa eshte me e larte.

Furnizimi me uje do t'ju sigurohet ne nje nivel te tille presioni, ne menyre qe te jete i mjaftueshem per te shperndare sasine e nevojshme te ujit edhe per katet e tjera te objektit, por jo aq sa te demtoje pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose te krijojë rreziqe tek konsumatori. Gjithashtu rrjeti hidraulik te furnizimit me uje per objektin do te sigurohet uje i pijshem i sigurt, bazuar ne Standardet Shqiptare, ne çdo kohe perdoruesve brenda sherbimit te zones se caktuar. Uji do te jete bakteriologjikisht dhe kimikisht i sigurt per perdorim sipas nevojave te caktuara ne perputhje me standardet shqiptare.

1.1. Shperndarje e informacionit per publikun.

Institucionet perkatese kane mundesuar informacion per projektin per gjithe Autoritetet Vendore, per Komunitetin si dhe per Kryetarin e Bashkise ku do te implemtohet projekti i propozuar. Pervec kesaj, personat pergjegjes kane njoftuar komunitetin kjo edhe e trajtuar gjeresisht ne mbledhjet e Keshillit te Bashkise rreth objektivave te projektit, impaktet e ngjashme e perfitimet nga realizimi i ketij projekti si dhe perfitimet per komunitetin e kesaj zone. Survejimi social-ekonomik i objekteve te prekura tregon se pjesa me e madhe e pergjigjeve kane qene pozitive per projektin para se te beheshin te tilla survejime.

Konsultimet me publikun do te behen ne perputhje me procedurat e percaktuara ne ligjin shqiptar per VNM, te perpunuar me sakte ne Rregulloren Nr.1 –Per pjesemarrjen publikell me titull –Per Pjesemarrjen Publike ne Proçesin e VNMI te dates 17.8.2004 (Nr.233 Prot.) te pergatitur nga MMPAU. Kjo rregullore eshte pergatitur ne zbatim te nenit 26 te ligjit per VNM.

1.2. Rreziku per aksidente dhe projekte te demshme.

Gjate funksionimit mund te sjelle rrezikshmeri per aksidente. Ne rast se do te kemi derdhje te lendeve si hidrokarbure nga automjetet e transportit do te merren masa per largimin e saj nga mjedisi si dhe do te vendosen tabela sinjalizuese per te shmangur aksidente rrugore gjate hyrjes dhe gjate daljes si nga kantieri i ndertimit dhe gjate shfrytezimit te zones.

Kodi	Rishqyrtimi	Data	Emetimi	Aprovimi	Faqja
III_1_A	Rev-0	03.06..2013	S_1	Inv	Faqja 28 nga 30

10. METODOLOGJIA PER CILESINE E UJERAVE DHE AJERIT

1. Procedurat e monitorimit për zbatimin e normave të lejuara, të paraqitura, që i bashkë lidhet këtij vendimi, përfshijnë:

- a) për llogaritjen e fluksit të përgjithshëm të shkarkuar të ujerave të ndotura, për një periudhë 24-orësh;
- b) marrjen e një mostre të ujerave të ndotura gjatë një periudhe 24-orësh dhe matjen e përqendrimit të substancave të rrezikshme në të;
- c) përcaktimin, ku është e mundur, të sasisë së substancave të rrezikshme të prodhuara, të trajtuara apo të përdorura, duke përdorur metodat e përlllogaritjes.

Sasia e substancave të rrezikshme, të shkarkuara në ujërat e ndotura gjatë një muaji, llogaritet si shumë e shkarkimeve të çdo dite, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij kreu.

Metodat e referencës për përcaktimin e pranisë së substancave të rrezikshme në ujërat e ndotura qejepen që i bashkëlidhet këtij vendimi. Gjithashtu, mund të përdoren edhe metoda të tjera, nëse ato sigurojnë rezultate minimalisht të njëjta me ato të metodave të referencës.

Procedurat e monitorimit për zbatimin e normave të lejuara, të paraqitura përfshijnë mbledhjen e mostrave, sipas fluksit të shkarkimeve ose një herë në 24 orë, në të njëjtën pikë të paracaktuar në dalje të impiantit të trajtimit të shkarkimeve të lëngëta urbane.

Numri minimal vjetor i mostrave, sipas pikës 4 të këtij kreu, përcaktohet në shkronjën "c", që i bashkë lidhet këtij vendimi.

Metodat e referencës, të përdorura për përcaktimin e normave të ujerave të ndotura urbane, jepen në tabelat 1 e 2 të shtojcës nr.4 te Vendimit 177, Datë 31.3.2005 "Për Normat e Lejuara të Shkarkimeve të Lengëta dhe Kriteret e Zonimit të Mjedisve Ujore Pritëse"

Ujërat e ndotura urbane plotësojnë kërkesat për normat e lejuara sipas këtij vendimi, vetëm nëse për çdo normë të marrë veçmas, mostrat e analizuara janë në përputhje me vlerat përkatëse, si më poshtë vijon:

- a) Kur normat e tabelës 1 të shtojcës nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, janë të shprehura në përqendrim, maksimumi i mostrave që lejohen të mos jenë në përputhje me kërkesat jepet në tabelën 3, të po kësaj shtojce;
- b) Kur normat e tabelës 1 të shtojcës nr.4 janë të shprehura në përqindje, mostrat që lejohen të mos jenë në përputhje me kërkesat, të marra në kushte normale pune, nuk duhet të ndryshojnë me më shumë se 100 për qind, për pezullime totale. Ndryshimet janë të pranueshme deri në 150 për qind;
- c) Për normat e përcaktuara në tabelën 1 të shtojcës nr.4 te Vendimit perkates, mesatarja vjetore e mostrave, për çdo normë, duhet të jetë në përputhje me vlerat përkatëse të normave të lejuara.

Bashkelidhur ketij relacioni vetmonitorimi jane flete analizat e vetmonitorimit

Sistemet e kolektorëve duhet te marrin parasysh kërkesat për trajtimin e ujerave te ndotura. Projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e tyre duhet te ndërmerret ne përputhje me metodat me te mira teknike dhe te mos ketë kosto shume te larte kryesisht lidhur me:

- Volumin dhe karakteristikat e ujerave urbane te ndotur;
- Parandalimin e rrjedhjeve;
- Kufizimin e ndotjes se ujerave te ardhur qe shkaktohen nga vërshimet e ujerave nga stuhitë.

Kodi	Rishqyrtimi	Data	Emetimi	Aprovimi	Faqja
III_1_A	Rev-0	03.06..2013	S_1	Inv	Faqja 29 nga 30

Tabela 1: Parametrat e lejuar te shkarkimeve ne uje

Parametrat	Përqendrimi	Metoda referente e matjeve
1	2	3
Nevoja biokimike për oksigjen (NBO-5) ne 20° pa nitrifikim	25 mg/l O ₂	Mostër e homogjenizuar, e pa filtruar e pa dekantuar. Përcaktimi i oksigjenit te patretur para dhe pas 5 ditësh ne inkubator ne 20° C, ne errësire te plote
Nevoja kimike per oksigjen (NKO)	125 mg/l O ₂	Mostër e homogjenizuar, e pa filtruar, e pa dekantuar. Oksidimi me potas bikromat (metoda e digestionit për 2 ore)
Lënda totale ne suspension	35mg/l per me shume se 10 000 nj.p.	Filtrimi i një mostre prezantuese nëpërmjet një membrane filtri (0,45mm metoda gravimetrie). Tharje ne 105° dhe peshim
Lënda totale ne suspension	60mg/l (2 000 - 10 000 nj.p.)	Centrifugimi i një mostre: prezantuese (për te paktën 5 minuta me akselerim nga 2 800 - 3200 g), tharje ne 105° dhe peshim.

Ky raport u pergatit nga:

Brisilda Saraci



Brisilda Saraci

Vleresues i Ndikimit ne Mjedis dhe Auditues Mjedisor

Nr. 675 Prot; Nr.229 Regj, me Vendim nr.9, date 30.10.2006